

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FEdu- Programi Parashkollor		
Titulli i lëndës:	Partneriteti em familjen dhe komunitetin		
Niveli:	BA		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	2+0		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Adelina Hajrullahu		
Detajet kontaktuese:	adelina.hajrullahu@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Kursi synon qe studentët të kenë mundësi të kuptojnë më shumë mbi rëndësinë që ka partneriteti me familjen dhe, njëkohësisht partneriteti me komunitetin. Kursi shtjellon nocionet, si: familje, partneritet, komunitet, si dhe çështjet që lidhen me to. Studentët mësojnë për teoritë që mbështesin partneritetin në mes të familjes dhe institucionit parashkollor, pastaj tipet e familjeve, edukimi i fëmijëve bazuar në rendin e lindjes, prindërimi, format e bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve, deri te adaptimi i fëmijëve në institucione parashkollore.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi teorik dhe praktik I studentëve për të njohur/kuptuar më mirë rolin e institucioneve parashkollore dhe rolin e familjes në edukimin dhe mirëqenin e fëmijëve të moshës së hershme; si dhe e kundërta, pastaj si bëhet adaptimi i fëmijëve 0 – 3 vjeç dhe adaptimi i fëmijëve 3 – 6 vjeç.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të: <ul style="list-style-type: none"> • Analizon dhe reflekton mbi teoritë dhe hulumtimet themelore mbi partneritetin e institucioneve parashkollore me familjen dhe komunitetin • Analizon dhe identifikon karakteristikat unike të familjeve dhe ndikimin e kulturës, prejardhjes sociale, gjuhës, aftësive, dhe vlerave në zhvillimin e fëmijëve • Promovojnë bashkëpunimin institucion parashkollor-familje-komunitet dhe aplikojnë qasje të ndryshme për partneritet me familjen dhe komunitetin • Identifikon format e bashkëpunimit në mes të institucioneve parashkollore me familjen dhe komunitetin • Analizon dhe identifikon praktikën e adaptimit të fëmijëve në institucione parashkollore • Vlerëson dhe reflekton mbi strategjitë e partneritetit në mes të institucioneve parashkollore dhe familjes bazuar në vëzhgimin gjatë praktikave të kaluara. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë / javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Konsultimet me mësimdhënësin	2	2	4
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj	5	2	10

Totali			120 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërimit; ushtrimet/punëtoritë dhe diskutimet në klasë, stimulimi i vetreflektimit, mendimit kritik dhe ndërveprimit grupor.</p> <p>Në secilën javë mësimi trajtohen edhe studime konkrete rasti, që shtjellohen nga mësimdhënësi dhe vet studentët, duke forcuar kështu tek studentët shkathtësitë vëzhguese, analitike, reflektive, dhe praktike për punën direkte me fëmijët.</p> <p>Do të përdoret classroom, si platforme për detyra dhe angazhime të studenteve</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësim sumativ: Kombinim i testeve dhe detyrave të tjera me pikëzim të caktuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja dhe diskutimi interaktiv -10% • Projekti (prezantimi) -20%, • Detyrat tjera -10% • 60% tjerë merren në provimin final ose nga dy testet gjatë semestrit 		
Metodat e vlerësimit të kursit	<ul style="list-style-type: none"> • Tiketa dalëse, dhe • Diskutim reflektues me studentë (në fund të ligjeratës). 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Zuna-Deva, A& bashkautorët (2009). Partneriteti shkollë – familje –komunitet, sfidë vijanoze, “Libri shkollor”.Prishtinë. • Sadoënik,A.R. & Višnjić Jevtić,.A.(2023). (Re)theorising More-than-parental Involvement in Early Childhood Education and Care. Springer natyre. • Zuna-Deva,.A. (2003).Edukimi i parashkollorit në familje.Prishtinë. • M.J.Kehily. (2009).An introduction to childhood studies. Open University – Press. • L.Jones,R.Holmes&J.Poëell (2005).Early childhood studies. Open University – Press . 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • E.Mato, P. Komani. (2001) Në kërkim të njohjes. Tiranë • IRIS Center. (n.d.). Star Legacy Modules. Collaborating ëith families,nga:http://iris.peabody.vanderbilt.edu/fam/chalcycle.htm, • L.Thornton, P.Brunton (2010). Bringing the Reggio Approach to the Early Years Practice. 		
Plani i dizajnuar i mësimi			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Nocionet themelore – partneritet, familje dhe komunitet		
Java e dytë:	Teoritë që mbështesin partneritetin		
Java e tretë:	Tipologjitë e familjeve		
Java e katërt:	Edukimi i fëmijëve bazuar në numrin e lindjes së tyre; fëmija i madh, fëmija i mesëm, fëmija i vogël; fëmija i dëshirit.Fëmija i adoptuar		
Java e pestë:	Përfshirja e familjes në edukimin e fëmijërve në moshë të hershme – prindërimi		
Java e gjashtë:	Parimet e partneritetit me familjen		
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë		
Java e tetë:	Format e bashkëpunimit me familjen dhe komunitetin		

Java e nëntë:	Adaptimi I fëmijëve 0 – 3 vjeç
Java e dhjetë:	Adaptimi I fëmijëve në institucione parashkollore nga mosha 3 – 6 vjeç
Java e njëmbëdhjetë:	Mjediset e të nxënit bashkëpunues, me qëllim vetëdijësimin e prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e fëmijërisë së hershme
Java e dymbëdhjetë:	Praktika mbi mbështjetjen e partneritetit me familjen dhe komunitetin
Java e trembëdhjetë:	Vlerësimi i dytë
Java e katërbëdhjetë:	Prezentimi i projekteve
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi i projekteve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

- Studentët janë të obliguar të jenë të pranishëm në të gjitha ligjeratat dhe ushtrimet. Studentët janë të obliguar të respektojnë kohën e fillimit të ligjeratave dhe shkyqjen e telefonave mobil.
- Secila mungesë e paarsyeshme do të mirret parasysh, dhe nëse studenti ka më shumë se tri mungesa do të ndikojnë në vlerësim dhe nuk do të ketë të drejtë të merr pjesë në provim.
- Studentët do të vlerësohen me punime, prezente, seminare si dhe detyra tjera që do të jipen gjatë semestrit. Kryerja e këtyre punimeve do t'i kontribuojë vlerësimit përfundimtar.
- Studentët janë të obliguar të respektojnë kolegët gjatë punës grupore dhe diskutimeve dhe të respektojnë këndvështrimet dhe mendimet e secilit student.